



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.211/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr. 914/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me date 01.04.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.62/2019 të datës 01.02.2019, të parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Beqir Mulsiu", lagjja Dadrani I, Rr.III Nr.94, Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Gjilan, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 neni 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e shqyrtimit dhe vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.62/2019 e datës 01.02.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër KA.1/2019 i datës 11.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjilan. **Anulohet** procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar Certifikues" e shpallur sipas konkursit me numër 3/2018 të datës 06.11.2018 nga Gjykata Themelore në Gjilan, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- III. **OBLIOGOHEM** Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilani ka shpallur konkursin e brendshëm me datë 06.11.2018 për pozitën "Zyrtar Certifikues" pas marrjes së autorizimit nga Departamenti i Administrimit të Shërimit Civil/Ministria e Administratës Publike të datës 05.11.2018

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në deri në fazën e testit me shkrim të procedurës së rekrutimit, pasi që nuk ka arritur piket e mjaftueshme në testin me shkrim .

Me njoftimin e datës 23.11.2018 Gjykata Themelore në Gjiilan, ka shpallur kandidatin e suksesshëm për pozitën "Zyrtar Certifikues".

Ankuesja e pakënaqur me Njoftimin e datës 23.11.2018 për përzgjedhjen e kandidates se suksesshme për vendin e punës „Zyrtar Certifikues” më datë 17.12.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjiilan.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjiilan, më datë 11.01.2019 ka nxjerr Vendim me numër KA.01/2019 me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar, duke e lënë në fuqi shpalljen publike të rezultateve për pozitën: "Zyrtar Certifikues", në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër KA.01/2019 të datës 11.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore të Gjiilanit, më datë 01.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 557/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.02.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Gjykata Themelore në Gjiilan, ndërsa më datë 25.02.2019 Gjykata Themelore në Gjiilan ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura .

Me datë 15.03.2019 ankuesja ka parashtruar parashtrëse për urgjencën e vendosjes se çështjes në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 1427/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 15.03.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.914/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.03.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 01.02.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr. 914/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje



Administrative; Urgjencë e datës 15.03.2019 nga ankuesja e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokollit Nr.557/2019 e datës 01.02.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Parashtrëse me numër te protokollit Nr.1427/2019 te datës 13.02.2019; Kërkesa për përgjigje ne ankese me numër të protokollit Nr.664/2019 e datës 06.02.2019; Përgjigja në ankese me numër të protokollit Nr.965/2019 e datës 25.02.2019; Autorizimi i Ministres së Administratës Publike (MAP) i datës 05.11.2018; Konkursi i brendshëm me numër te protokollit Nr.332/18 i datës 06.11.2018; Krekës për punësim e datës 12.11.2018 e kandidatës Çertifikata e datës 14.12.2007: Çertifikata numër Nr.43/2016: Çertifikata e lëshuar nga organizata USAID e datës 04.06.2013; Çertifikata e datës 06.06.2014; Diploma e studimeve themelore e kandidatës e datës 15.07.2015: Formulari për Vlerësimin e rezultateve ne pune për vitin 2017 i Gjykatës Themelore ne Gjilan: Vendimi me numër të protokollit Nr.03.2183 i datës 29.12.2015 mbi caktimin Ushtrues Detyre Zyrtar Çertifikues ne Gjykatën Themelore ne Gjilan: Akte Emërimi me numër te protokollit 03.112-379 i datës 28.12.2012; Rekomandimi i datës 12.11.2018; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Çertifikata e kandidatës i datës 22.11.2018; Testi me Goje për pozitën Zyrtar i Çertifikata e kandidatës datës 22.11.2018; Vendimi me numër te protokollit 337/18 i datës 16.11.2018 për formimin e komisionit përzgjedhës; Regjistri i Aplikacioneve te Pranuara i datës 19.11.2018; Form.MAP-SHCK-01 Kërkesa për Fillimin e Rekrutimit e datës 18.10.2018; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen ne Listën e ngushte; Raporti i datës 19.11.2018 lidhur ne shqyrtimin e aplikacioneve për listën e ngushte për pozitën Zyrtar Çertifikues; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues 22.11.2018; Lista e Selektimit te Ngushte e datës 19.11.2018; Njoftimi i Kandidateve për Mbajtjen e Intervistës e datës 20.11.2018 ; Procesverbali i mbajtur me 22.11.2018; Përmbledhja e vlerësimeve Individuale e datës 22.11.2018; Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 22.11.2018; Njoftimi ne faqen zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit; Flete dërgese me numër KA 1/19 i datës 14.01.2019; Vendimi me numër të protokollit Nr.KA.1/19 i datës 11.01.2019 i Komisionit për Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 17.12.2018 e ankuses drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve; Kërkesa për Punësim e datës 13.11.2018 e kandidatës Diplome e datës 14.03.2014 kandidatës Certifikate e datës 14.12.2007; Çertifikat lëshuar nga organizata USAID ne periudhën kohore Prill-Korrik i vitit 2009; Çertifikate e datës 25.10.2001; Rekomandim i datës 13.11.2018; Vërtetim i datës 20.09.2002; Akte emërimi me numër te protokollit 392/16 i datës 07.11.2016 i kandidatës Akte emërimi me numër te protokollit Nr.112-305 i datës 28.12.2012; Testin me Shkrim i datës 22.11.2018 për Pozitën Zyrtar Certifikues i kandidatës Flete dërgesa e datës 14.01.2019 Gjykatës Themelore në Gjilan drejtuar kandidatës Parashtruar urgjencë e datës 15.03.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 1427/2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuses, lidhur me atë se Gjykata Themelore në Gjilan procedurën e rekrutimit për

pozitën "Zyrtar Certifikues", e ka bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/ L-149, për Shërbimin Civil të Kosovës, si Rregulloren Nr. 02/2010, për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në baze të dëshmive të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar Certifikues" është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, është i qëndrueshëm sepse Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka qenë i themeluar në kundërshtim me Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, respektivisht Vendimi me Nr. 337/18 i datës 16.11.2018 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: *"Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet, po një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor. KPSHC zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitat e karrierës dhe të jo karrierës".* Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmive të ofruara, konkretisht në bazë të akt emërimeve të anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil ka konstatuar se përbërja e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse në Komision është emëruar një nëpunës civil, që e ka pozitën më të ulët se pozita që është rekrutuar, sepse sipas dëshmisë së ofruar respektivisht Akt emërimit me numër 172/2016 të datës 10.05.2016, anëtari i komisionit mban pozitën „Bashkëpunëtor profesional” me koeficient 8 ndërsa pozita e cila është rekrutuar „Zyrtar Certifikues” është me koeficient 9.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh shkeljet procedurale të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës”.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjilan me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA,1/19 të datës 11.02.2019 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit N. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses lidhur me zhvillimin e procedurave të Rekrutimit për pozitën "Zyrtar Certifikues".

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Gjykata Themelore në Gjilan, pas pranimit të këtij vendimi me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës, për pozitat e nivelit profesional duhet ti eliminoj të gjitha shkeljet dhe të gjeturat e këtij vendimi, dhe duhet të veprojë në pajtim me dispozitat

ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në shërbimin Civil.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.914/19 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, te pranuar me 01.04.2021, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.62/2019.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative
- Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjilan
- Arkivit të KPMSHCK-së.